



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

PROCESVERBAL

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Më datë 6 mars 2018, ora 14:00, pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri nisi mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).

Të pranishëm janë:

Për përfaqësuesit e institucioneve publike:

1. Znj. Ogerta Manastirliu
2. Znj. Merita Xhafaj
3. Znj. Majlinda Dhuka, në mungesë të z. Engjëll Agaçi
4. Z. Sofjan Jaupaj, në mungesë të znj. Daniel Pirushi
5. Z. Fran Brahimi, në mungesë të znj. Gelardina Prodani
6. Znj. Odeta Barbullushi
7. Znj. Alma Baze

Për përfaqësuesit e shoqërisë civile të KKShC-së:

1. Z. Blendi Dibra
2. Z. Altin Hazizaj
3. Z. Ergys Gezka
4. Z. Vladimir Thanò
5. Znj. Iris Luarasi
6. Znj. Emanuela Zaimi
7. Znj. Arta Dyrmishi
8. Z. Luan Ahmetaj
9. Znj. Mirela Koçi
10. Znj. Zana Vokopola
11. Znj. Afërdita Seiti
12. Znj. Artemisi Shehu
13. Z. Ali Coka

Përfaqësues nga AMShC:

1. Z. Andi Kananaj
2. Z. Erion Banushi
3. Znj. Ina Gjini
4. Z. Andi Luga

Znj. Ogerta Manastirliu, në cilësinë e Kryetares së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) mban fjalën e hapjes. Ajo nënvizon se procesi i dialogut dhe këshillimit që zhvillohet në Këshillin Kombëtar bazohet në tri parime:

1. **Parimi i këshillimit**, nëpërmjet këmbimit të sugjerimeve, vërejtjeve dhe rekomandimeve që propozon ky Këshill
2. **Parimi i transparencës**, nëpërmjet komunikimit në faqet zyrtare të rekomandimeve të nxjerra nga Këshilli gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, si dhe njoftimin dhe vënien në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile të rekomandimeve të propozuara nga ky Këshill
3. **Parimi i konsultimit**, nëpërmjet përfshirjes së grupeve të ndryshme të interesit në këtë proces

Ajo shprehet: “Nisur nga këto parime, që nga mbledhja e parë e deri më sot ne kemi mirëpritur takimet me përfaqësuesit e shoqërisë civile të cilët kanë dhënë sugjerime mjaft të rëndësishme e të vyera për zhvillimin e këtij procesi si dhe falenderoj Blendin për bashkëpunimin.”

Gjithashtu ajo shtoi se së fundmi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka konstituar dy Këshille:

1. Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
2. Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore

Znj. Ogerta u shpreh: “Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës do të formohet nga 5 (pesë) anëtarë të cilët do të përzgjidhen nga Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile në një proces transparent, do të publikohet në faqen web të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë.

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore është ngritur me urdhër të Kryeministrit në dhjetor të vitit 2017, u mblodh pikërisht ditën e djeshme me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe tre përfaqësues të shoqërisë civile të përzgjedhur nëpërmjet një procesi transparent.

Në mbledhjen e tij të parë ky Këshill ka miratuar raportin për zbatimin e strategjisë për vitin 2017 dhe planin e masave për zbatimin e rekomandimeve urgjente. Këto dokumenta do t'i gjeni të publikuara edhe në faqen web të Ministrisë.

Gjithashtu kemi ndarë me përfaqësuesit e shoqërisë civile një seri aktesh nënligjore që kemi përgatitur në zbatim të dy ligjeve shumë të rëndësishme për të cilat po punohet aktualisht: Ligji për shërbimet shoqërore dhe Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe mbrojtjen e të miturve.

Aktivizmi i këtyre Këshilleve tregon se vullneti për të patur një dialog sa më konstruktiv nuk mungon.”

Para se të vazhdojnë punimet konfirmohet kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e mbledhjes: Nga anëtarët e shoqërisë civile të KKShC-së marrin pjesë të 13 anëtarët dhe nga institucionet publike marrin pjesë përfaqësues nga Këshilli i Ministrave; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Kulturës; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Më pas, znj Ogerta kalon tek rendi i ditës duke përmendur pikat e axhendës.

Pika e parë është miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së fundit të KKShC-së i mbajtur më datë 26.12.2017, i cili miratohet unanimisht.

Në pikën e dytë të rendit të ditës është miratimi i Kalendarit të Vitit 2018.

Z. Blendi bën një prezantim të shkurtër të pikave të Kalendarit. Gjatë diskutimit u vendos që Konferenca e Parë Kombëtare të bëhet në muajt Shtator – Tetor dhe jo në Prill – Qershor.

Znj. Ogerta nënvizon se takimet rajonale janë shumë të rëndësishme duke qenë se mbledhja e ardhshme e KKSHC-së do të bëhet në qershor dhe do të ishte mirë të vinin me një raport nga këto konsultime dhe diskutime.

Kryetarja e KKShC-së shton: “Propozimet për hartimin ose ndryshimin e ligjeve do të jenë një nga detyrat më të rëndësishme të Këshillit. Kemi Draft-Ligjin për financimin e organizatave të shoqërisë civile në nivel qendror dhe vendor; Draft-Ligjin për TVSH-në dhe taksimet dhe amendimet e Ligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Këto propozime kërkojnë angazhim dhe plan pune edhe nga ana e Këshillit, sepse sa më të organizuar të jemi ne në lidhje me respektimin e afatave aq më të lehtë do ta kemi organizimin.”

Znj. Emanuela shton se gjithashtu janë për t'u propozuar dhe diskutuar edhe Draft-Ligji për ndërmarrjen sociale dhe Ligji për sponsorizimet.

Znj. Ogerta shprehet: “Lidhur me Ligjin për ndërmarrjen sociale jemi duke punuar e miratuar aktet ligjore, dhe do të viheni në dijeni në mënyrë që edhe ju të jepni mendimin tuaj.”

Gjithashtu ajo shton: “Do të koordinojë punën në Ministri në mënyrë që këto tre draft-ligje të futen në kalendarin e Kuvendit për miratim. Ky është një proces që ka nevojë për kohën e tij, do të dëgjohen grupet e interesit dhe gjithashtu do të krijohen grupe ndër-insitucionale dhe më pas do të vendosim për kalendarizimin në punimet e Kuvendit.”

Znj. Majlinda Dhuka shprehet: “Këshilli i Ministrave miraton programin analitik të akteve ligjore, të cilin e kanë miratuar për vitin 2018, kështu që këto nisma do të shikohen edhe në kontekstin e planifikimit të akteve ligjore që janë veprimtari e ministrive të ndryshme. Nga ana tjetër ju e dini që jemi duke punuar për rishikimin e Udhërrfyesit, i cili parashikon si aktivitete edhe paketat ligjore. Këto iniciativa janë propozime të bëra nga anëtarët e shoqërisë civile iniciativë të cilën e përshëndes në mënyrë të veçantë.”

Anëtarët e shoqërisë civile shtojnë gjithashtu se edhe Ligji për vullnetarizmin duhet të rishikohet.

Z. Altin shprehet: “Një propozim tjetër është që të bëhet një shtesë në aktivitetet përse i përket çështjes së buxhetit të shtetit. Pjesë e vazhdueshme e Këshillit duhet të jetë edhe shqyrtimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me buxhetin e shtetit.”

Znj. Majlinda shprehet: “Disa anëtarë të KKSHC-së janë anëtarë të Këshilleve dhe komiteteve të tjera, do të rekomandoja që anëtarët e Këshilleve të tjera të gjejnë rastin të informojnë KKSHC-në mbi veprimtarinë e zhvilluar në mbledhjet e këtyre Këshilleve periodikisht në mënyrë që të krijojmë një lidhje midis veprimtarisë së këtij Këshilli dhe përfaqësimit nga ky Këshill në Këshille të tjera, që mund të jenë çështje të karakterit ekonomik ose të drejtat e fëmijëve dhe të tjera të ngjashme.”

Z. Ali propozon se duhet përmirësuar manuali i Shërbimeve Mjedisore, manuali i Granteve operacionale tek AZHBR.

Z. Blendi i propozon të sillen të gjitha këto propozime me shkrim në mënyrë që të shihen më me detaje.

Në vijim të prezantimit për nismat ligjore, fjalën e merr z. Altin, i cili flet për punën në grupe për prezantimin e drafteve ligjore. Ai shprehet: “Grupi ynë është marrë me diskutimin për projektligjin “Për mbështetjen e financimit të fondeve shtetore të organizatave jofitimprurëse”. Për këtë propozim kemi patur një konsultim paraprak me mbi 100 organizata të shoqërisë civile, që janë përfshirë në takimet konsultuese dhe kemi një draft së bashku me relacionin shoqërues. Ky grup pune i ngritur nga antarët e shoqërisë civile në KKSHC punoi që pas përfundimit të mbledhjes së parë zyrtare të KKSHC dhe sot paraqet për konsideratë këtë projekt-ligj të

rëndësishëm për mbështetjen dhe fuqizimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Projek-ligji është ndërtuar në praktikat më të mira të vendeve Europiane. Ne sot i rekomandojmë KKSHC miratimin e tij dhe paraqitjen në Këshillin e Ministrave për të ndjekur rrugën ligjore të miratimit të tij përfundimtar në Kuvendin e Shqipërisë.”

Znj. Ogerta flet për një instrument të ri, që është ai i Fondit Social që është akoma në diskutim dhe për të cilin do të flitet edhe në mbledhjet e tjera të Këshillit.

Në vijim, znj. Mirela prezanton problematikat e hasura dhe sugjerimet e përgatitura nga grupi i punës i ngritur për çështjet lidhur me sistemin e TVSH-së, taksave lokale, financimeve publike të OShC-ve, Co-financimit për projekte të KE-së, barrës së garancisë bankare për OShC-të Lead Partner të projekteve të KE-së. Ajo sugjeron për znj. Ogerta dhe znj. Majlinda që përfaqësues të grupit të KKShC-së ngritur për të adresuar çështjet e financimit dhe fiskalitetit të OShC-ve t’i bashkohen grupeve të punës të ngritura dhe koordinuara nga Kryeministria, duke qenë se dy prej nismave u relatuan nga znj. Ogerta si nisma të iniciuara.

Znj. Zana shtoi nevojën e koordinimit midis Kryeministrit, Ministrive të linjës dhe Asistencës Teknike të Delegacionit Evropian për propozimin e nismave konkrete ligjore si edhe të një regjistri elektronik për regjistrimin e OJF-ve.

Znj. Majlinda shpjegon: “Përsa i përket çështjeve organizative, masat e propozuara janë pjesë e Udhrrëfyesit dhe për këtë qëllim është ngritur një grup pune ndër-institucional, ku përfshihen institucionet publike si Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ministrët e tjera. Koordinimi i grupit të punës realizohet nga departamenti që unë drejtoj. Sipas natyrës së masave (në një rast për regjistrin në një rast për financën) mund të bashkëpunojmë. Çështja e regjistrit për shembull është duke u trajtuar. BE po na ndihmon për të bërë një studim fizibiliteti për një regjister elektronik, për një *database* për shoqëri civile duke vlerësuar nëse të dhënat që ekzistojnë sot pranë Drejtorisë së Përgjithsme të Tatimeve ose gjykatave janë të mjaftueshme apo kemi nevojë për të krijuar një platformë regjistrimi dhe informimi më të konsoliduar. Duhet vetëm të bashkojmë kontributet për t’i dhënë një zgjidhje përfundimtare kësaj çështje.”

Znj. Emanuela flet për propozimet e grupit të saj, që janë Ligji për sponsorizimet dhe ndërmarrjet sociale.

Ajo shprehet: “Ligji për Sponsorizimin, azhurnimin e fundit e ka në vitin 2007 dhe besojmë se ka ardhur koha për ta riparë. Rekomandimi ynë më i rëndësishëm është që duhet të qartësohet pjesa e filantropisë, pra të rregullohet me një ligj të mirë, të mos quhet vetëm si aktivitet, por të jetë e rregulluar brenda këtij ligji duke patur parasysh të dyja drejtimit: edhe filantropinë e bërë nga Korporatat dhe Bizneset, por edhe nga Donacionet që mund të bëhen nga Korporata ose individëve. Ndërsa për ndërmarrjet sociale Ligji është tentuar të bllokohet shumë nga aktorë që

janë sipërmarrës socialë. Ky ligj që është kaluar ka disa kërkesa arbitrare, si psh: pjesa nëse dikush humb statusin e sipërmarrësit social pas detyrimit të palëve të treta, pa dhënë asnjë kontribut shtetit, çuditërisht një kapital i kalon shtetit ose një ndërmarrje tjetër sociale, gjë e cila është shumë e pavend dhe e gabuar.

Gjithashtu është lënë jashtë koncepti i talentit të sipërmarrësit, nuk duhet vetëm të kemi një impakt social, është shunë e rëndësishme të jetë fitimprurës. Sipërmarrja sociale është parë si një detyrim vetëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërkohë që duhet të përfshihen edhe Ministri të tjera.”

Znj Majlinda shprehet se këto çështje duhen shtruar në grupet teknike ndër-institucionale.

Ajo shton: “Ndërmarrja sociale dhe sipërmarrja sociale janë dy koncepte të ndryshme. Nga vendimet e Këshillit të Ministrave ka mbetur vetëm një vendim pa rënë dakort për çështjen e subvencioneve, është diskutuar edhe me ju dhe në komisionin parlamentar. Jam dakort me propozimin e Emanuelës, që sipërmarrja sociale është një nismë tjetër që mund të zgjerohet dhe ka nevojë edhe të promovohet, por le ta nisim njëherë me ndërmarrjen sociale, ku fitimi në fund të vitit duhet të testohet për rritjen e numrit të vendeve të punës brenda një strukture të ndërmarrjes sociale. Pjesa e aseteve flitet vetëm për asetet e krijuara me subvencionin që merret nga shteti.”

Z. Vladimir, prezanton çështjet e përgatitura nga grupi i punës mbi regjistrimin e OJF-ve dhe thotë se u është referuar shqetësimeve që kanë organizatat e shoqërisë civile për regjistrimin dhe funksionimin e shoqërisë civile. Sistemi aktual nuk e nxit regjistrimin e shoqatave sidomos atyre me antarësim duke parashikuar sistem të centralizuar të regjistrimit në gjykata. Sot bizneset regjistrohen në QKB, ndërsa shoqatat kanë mbetur në gjykatë. Kostoja noteriale duhet riparë dhe duhet facilituar procesi. Duhet ngritur grup ekspertësh për të riparë Ligjin për funksionimin dhe regjistrimin e organizatave të shoqërisë civile.

Në vijim të diskutimit, znj. Merita lidhur me zgjerimin e bashkëpunimit mes anëtareve të Këshillit dhe grupeve të eksperteve sugjeroi caktimin e një personi kontakti nga anëtarët e shoqërisë civile në Këshill dhe të shënohet në procesverbal.

Në përfundim të mbledhjes, të ftuarit i drejtuan disa pyetje anëtarëve të Këshillit.

Fjalën e mori z. Indrit Seferi, përfaqësues i organizatës “MAYA (Medical Association Youth Albania)”, i cili paraqiti problematika të hasura në sektorin shëndetësor.

Znj. Ogerta u bën të ditur të pranishmëve se në çdo ministri është ngritur një zyrë informimi me qëllim komunikimin me organizata të shoqërisë civile, ku ftohen të adresojnë problematikat e tyre.

Në vijim, fjalën e merr znj. Zamira Korançe, përfaqësuese e Shoqatës Kulturore Artistike "Jehona Shqiptare", e cila shprehet se mes vështirësive dhe pa mbështetje financiare, kjo organizatë promovon vlerat dhe sidomos të drejtat e fëmijëve si dhe po realizon për të katërin vit radhazi Festivalin Mbarëkombëtar të Fëmijëve nga 14 shtete me folklore 100% shqip. Megjithëse kam aplikuar për fonde sipas thirrjeve të shpallura nga institucione të ndryshme, aplikimi im nuk është marrë parasysht, duke më thënë se mungon një dokument.

Znj. Ogerta i përgjigjet duke i thënë se ky Këshill ka për qëllim të mbledhë propozime në mënyrë që të adresohen në strukturat përkatëse dhe të merren nisma apo ndryshime ligjore në funksion të mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile dhe përfshirjen më shumë të tyre në programe e politika të Qeverisë.

Më pas, fjalën e merr përfaqësuesi nga ACLI - IPSIA (Shqipëri), i cili bën një prezantim të veprimtarisë së kësaj organizate. Ai parashtroi kërkesën për të ndërmarrë nisma që të fasilitojnë pjesën e implementimit të ligjeve.

Znj. Ogerta pasi e falenderon përfaqësuesin e organizatës shprehet se kjo kërkesë apo sugjerim do të regjistrohet nga Sekretariati teknik i KKShC-së.

Në vijim, fjalën e merr znj. Irena Laska – Drejtore ekzekutive e “Shoqatës Kujdesi Shëndetësor Familjar (Qendra e Kujdesit Paliativ Mary Potter)”, e cila paraqet problematikën e hasur në dhënien e recetave.

Znj. Ogerta shprehet se mbështet kauzën e të sëmurëve paliativë dhe siguron organizatat e kësaj fushe se Ministria që drejton ka marrë masa që në bazë të disa rregullave të vendosura të mos mungojë dhënia e recetave dhe ilaçeve dhe siguron se nuk do të mungojë për asnjë moment. Ajo thotë: “Gjej rastin t’ju falenderoj edhe në emër të Ministrisë për gjithë punën që bëni dhe se jeni një nga organizatat me ekspertizë më të mirë. Jemi këtu dhe po diskutojmë për nisma ligjore dhe formalizim. Problematika e hasur kërkon një Udhëzim ose instrumenta ligjorë brenda Ministrisë dhe Fondit Shëndetësor, pra brenda një strukture që ka nevojë për formalizim.”

Znj. Irena sugjeron që të përfshihet në KKShC shoqata më shumë me profil nga shëndetësia, sepse ka vërtetë probleme.

Znj. Afërdita Seitit ndërhyr dhe shton se si anëtare e KKSHC-së përfaqësuese e “Fushës C. – Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës” i bën të ditur të pranishmëve se KKSHC do të zhvillojë tre takime konsultative lidhur me tematikat për shëndetin dhe u siguron se çdo ankesë apo sugjerim do të adresohet në takimin e radhës.

Më pas fjalën e merr z. Artur Ribaj, drejtues i “Institutit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik të Shqipërisë”, një organizatë shumë e re dhe me vepron mbi bazë vullnetare me student, të lëndës së Sipërmarrjes dhe Etikës. Z. Artur thotë: “Falënderoj AMShC-në për ftesën e marrë në këtë mbledhje dhe se diskutimet që dëgjova këtu janë mjaft të vlefshme dhe në vijim të çfarë u tha dhe për këto iniciativa, është mirë të kontaktohem për të dhënë kontributin tonë vullnetar.”

Z. Altin sugjeron që të shtohet një nen në Rregulloren e KKShC-së, ku organizatat e shoqërisë civile t’i adresojnë problematikat e tyre drejt 13 anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së, në mënyrë që të bëhet edhe një organizim më i mirë i paraqitjes së tyre në takimet e radhës.

Znj. Ogerta i përgjigjet z. Altin se këto sugjerime t’i diskutojmë në mbledhjen e ardhshme, të regjistrohet në procesverbal dhe më pas t’i kalojë anëtarëve të Këshillit për ta ndarë si ndryshim në Draft-Rregullore dhe më pas për ta kaluar në votim në rendin e ditës në mbledhjen e ardhshme.

Më pas mori fjalën znj. Paola, një përfaqësuese e një organizate shumë të re me fokus zhvillimin e vlerave të lidërshpit tek të rinjtë. Ajo shprehet se e vlerëson takimin e sotëm dhe kërkon të vazhdohet kontakti për takime të tjera. Ajo shfaq problematikën se si shoqatë e re ka nevojë për mbështetje për të patur qëndrueshmëri, që mund të realizohet nga një asistencë teknike që mund të vijë nga Këshilli.

Znj. Ogerta i përgjigjet se Delegacioni i BE-së ka një skemë që mbështet organizatat e reja. Gjithashtu ajo sugjeroi se mund të bëhet që edhe në Këshill të ngrihet një nën-komision që jo vetëm të asistojë dhe monitorojë organizatat e reja, por edhe t’i mbështetë me fonde, dhe që mund të formohen konsorciume gjithashtu për aplikime për projekte, por të jeni të gjithë bashkë dhe të shihet se sa hapsira ligjore ka.

Në orën 15:55 mbledhja mbyllet.

SHTOJCA 1:

KALENDARI I AKTIVITETEVE 2018

Mbajti procesverbalin:

Znj. Ina Gjini

Zv/Kryetar i KKSHC

Z. Blendi Dibra



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

KALENDARI I AKTIVITETEVE 2018

Aktiviteti 1: Mbledhjet periodike të KKSHC

Sipas sektorëve të përcaktuar nga Ligji / sipas çështjeve

Vendi: Pranë ambienteve të AMSHC-së, ora 08:00 -16:30

Aktiviteti 2: Propozimet mbi hartimin e ligjeve apo ndryshimet ligjore:

2.1 Draft-ligji për financimin e OSHC-ve në nivel qendror dhe vendor

- a) *Organizimi i takimeve me përfaqësues të BE*
- b) *Konsultime me përfaqësues të Institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal*
- c) *Konsultime me përfaqësues të OJF-ve.*

2.2. Draft-ligji/Amendamente për probleme të taksimit të OJF-ve/TVSH

- a) *Organizimi i takimeve me përfaqësues të Ministrisë së Financave*

2.3. Amendime të ligjit për regjistrimin e OJF-ve

- a) *Hartimi i propozimeve për amendimin e ligjit*

Aktiviteti 3: Monitorimi i zbatimit të Udhërrëfyesit/Roadmap

Takime me përfaqësues të Kryeministrisë dhe institucioneve publike për të grumbulluar informacionin zyrtar në lidhje me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Udhërrëfyes sipas afateve përkatëse

Aktiviteti 4: Organizimi i tre takimeve rajonale konsultuese me OJF-të:

- *Progres zbatimi i Roadmap*
- *Prezantimi i planit strategjik për KKSHC*
- *Prezantimi i iniciativave ligjore të KKSHC të përgatitura nga aktiviteti 2 dhe grupet e punës sektoriale*

Data: Prill – Qershor 2018

Aktiviteti 5: Organizimi i **Konferencës së Parë Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë Civile:**

- *prezantimi i progresit në lidhje me çështjet e trajtuara në grupe pune nëpërmjet aktiviteteve 1, 2, 3.*
- *Përcaktimi i prioritetëve dhe hartimi i planit strategjik*

Vendi: Tiranë

Pjesëmarrës: Përfaqësues të institucioneve publike dhe parlamentit, donatorë potencial, organizata ndërkombëtare, përfaqësi diplomatike, përfaqësues të OJF-ve etj

Data: Shtator - Tetor 2018

Aktiviteti 6: Organizimi i Mbledhjeve Zyrtare të KKSHC-së për vitin 2018

6.1 Mbledhja e parë zyrtare: Mars 2018

- *Miratimi i kalendarit të aktiviteteve të KKSHC*
- *Miratimi i raportit vjetor (i cili do përgatitet me asistencën e ekspertëve të BE-së)*
- *Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës me përfaqesuesit e institucioneve publike në funksion të realizimit të aktivitetit 2 dhe 3*
- *Miratimi i organizimit të Konferencës Kombëtare të Shoqërisë Civile*

6.2. Mbledhja e dytë zyrtare e KKSHC: Korrik 2018

6.3. Mbledhja e tretë zyrtare e KKSHC: Nëntor 2018